

## **AKTI I THEMELIMIT**

### **DHE**

## **STATUTI I SHOQERISE**

### **La Brasa Sh.p.k.**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit", une e nenshkruara shpall si me poshte vijon:

## **FORMIMI I SHOQERISE**

### **Neni 1**

Formohet shoqeria e quajtur "La Brasa" Sh.p.k. (qe me poshte do te quhet "Shoqeria") me ortake:

**Z. Gentjan Reçi**, shtetas shqiptar, lindur me 08.05.1971 ne Tirane, dhe banuese ne Tirane me nr personal nr. **H10508048R**, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

## **SELIA E SHOQERISE**

### **Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen : **Njesia Administrative Nr. 7, Rruga Marsel Kashen, Nd. 1 H. 1, Nr Pasurie 7/16+8-849, ZK 8330 , Tirane.** Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

## **KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

### **Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar kohore, e cila fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

### **Neni 4**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Bar-kafe,piceri,restorant.
- Import-eksport te mallrave te ndryshem.
- Cdo veprimtari tjeter qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### **Neni 5**

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

## **KAPITALI I SHOQERISE**

### **Neni 6**

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 ( njeqind mije ) leke dhe i ndare ne 1 (nje) kuote me vlere nominale 100.000 lekë. Cdo ortak ka te drejten e votës.

Kontributi i ortakevut ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- **Z. Gentjan Reçi** zoteron 1 kuote e barabarte me 100 % te kapitalit fillestar te shoqerise, me vlere 100.000 Leke.

-

### **Neni 7**

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

## **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

### **Neni 9**

Ortaket e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

## Neni 10

Kuotat e çdo anetari përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anetari i shoqërisë mund t'ua ofrojnë të treta. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotave përpara personave të treta jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Administratorit duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtit me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të treta jashtë shoqërisë si dhe të dhenat e blerësit. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Edhe e drejta e përparësisë për nënshkrimin e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

E drejta e përparësisë për nënshkrimin e kuotave është në proporcion me kuotat që zoteron secili prej ortakëve në këtë shoqëri. Administratori pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh dhe në rast se ortakët do të blejnë këto kuota, i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Transferimi dhe shitja e kuotave mund të bëhen me akte noteriale ose pa akt noterial dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

## Neni 11

Emertimi i shoqërisë tregtare, forma ligjore e shoqërisë, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqërisë, emri i administratorit, duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri, nëpërmjet përdorimit të letres apo mjeteve elektronike, dhe që ju drejtohen të treta. Shoqëria ka vullnet të saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

## Neni 12

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortakët e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të treta pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Ortakëve.
- 2- Administratori.

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE

### Neni 13

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve e cila mund të thirret nga çdo anëtar i shoqërisë që përfaqëson të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë. Anëtarët duhet të njoftohen me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 7 ditë përpara dhe në lajmerim duhet të jetë shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit të ditës që do të trajtohen në mbledhje.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullsise.

## **TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE**

### **Neni 14**

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

#### **1) *Asambleja e Zakonshme:***

Mblidhet te pakten 1 here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Asambleja e zakonshme e ortakeve merr vendime te vlefshme kur jane prezent apo te perfaqesuar me prokure ortaket qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendos edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise ose nuk eshte lene ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme

#### **2) *Asambleja e Jashtezakonshme:***

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statutit.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me keto ceshtje;
- Vendos ne lidhje me çdo ceshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj .
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj .
- Si dhe çdo ceshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.

## Neni 15

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme te Ortakeve te cilat jane marre ne nje mbledhje te thirrur ne menyre te rregullt dhe konform kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithë ortaket e tjere, edhe per ata qe nuk kane diskutuar ose nuk kane qene dakord.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesoje me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjetër me prokure te posacme.

## Neni 16

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

## ADMINISTRIMI

### Neni 17

Shoqeria administrohet nga administratori i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperseritjeje. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ua jep shprehimisht ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte **Z. Gentjan Reçi** me nr personal . **H10508048R**.

Administratori zgjidhet per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

## Neni 18

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### **Neni 19**

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

### **MARREDHENIET E PUNES**

#### **Neni 20**

Maredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

#### **Neni 21**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

## **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

### **Neni 22**

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

## **BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 23**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

### **Neni 24**

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 25**

Ne rast se shoqeria priset per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

## **LIBRAT E SHOQERISE**

### **Neni 26**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te organit administrativ
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperme duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 27

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit", dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

ORTAKU I SHOQERISE

*Genjani Keci*



Tirane , me 04.10.2021